



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 14-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 28.02.2019 (e enjte), në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 13. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 14. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 15. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 16. Arben Kabashi, PDK; |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 17. Ajshe Metaj, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 18. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 19. Agron Avdijaj, VV; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 20. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 21. Arif Elshani, IQ; |
| 10. Naim Imeraj, AAK; | 22. Radoš Repanović, SL; |
| 11. Nexhmedin Balaj, AAK; | 23. Radenko Belošević, RB dhe |
| 12. Muhamet Ukaj, AAK; | 24. Slaviša Maliković, SM. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe Nënkryetari i Komunës z.Agim Ademaj, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z.Qaush Balaj.

Kryesuesi, përshëndeti të pranishmit dhe për këtë mbledhje propozoi këtë :

R e n d d i t e

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba;
4. Shpallja në diskutim publik e plotësim-ndryshim rregullores për ndarjen e bursave për studentë;
5. Shpallja në diskutim publik Projekt-Rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal, miqësor për fëmijët;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së për vitin 2019 dhe
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, pyet nëse ka diçka dikush për këtë rend dite? Kush është që të vazhdohet më këtë rend dite?

Kuvendi me 19 vota për, 3 abstenime miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Haki Podrimaj, Jehona Haxhijaj dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Radoš Repanović.

Radoš Repanović, përshëndeti të pranishmit. Nëse më lejoni pak minuta sa i përket rendit të ditës, ne të tre nga Lista Serbe kemi filluar me bojkotimin e kësaj mbledhje ka disa muaj për arsye të mos punës tuaj, për arsye të buxhetit katastrofal, sepse ju i kushtoni kujdes vetëm palës shumicë e jo bashkësisë serbe që ne e përfaqësojmë edhe pse kemi marrë pjesë në votim. Prandaj në mbledhjen e kaluar ne kemi lëshuar mbledhjen. Ju lutem të keni vëmendjen sepse Kuvendi nuk po funksionon si duhet, siç ju thashë më parë buxheti është planifikuar në mënyrë katastrofale, posaçërisht sa i përket bashkësisë serbe, ku nuk parashihet asnjë euro investim pra në këtë buxhet të aprovuar nuk është ndarë asnjë euro. Unë nuk e di arsyen, nuk e di nëse janë të njoftuar kryetarët e Bashkësisë Ndërkombëtare, të cilët e mbikëqyrin, si dhe ministria, pra nuk parashihet as vetëm edhe një euro për investime nga ky buxhet. Ju njoftoj se ne nuk do t'i japim legjitimitet këtij lloj kuvendi, kësaj lloj qeverisjeje dhe ju ftoj që të merrni parasysh kërkesat tona, të filloni me vullnet të mirë. Si për shembull z.Rugova, duhet të angazhoj personat përgjegjës dhe tu thotë se ka 10 vjet që nuk punon ndriçimi, pra në shekullin XXI nuk punon ndriçimi në rrugët e Osejanit, ku 90% të popullit atje i kryejnë obligimet e tyre. A doni z.Rugova që të thërrisni në këto momente personat përgjegjës që të ndreqin këtë ndriçim? Nëse kjo nuk ndodhë, pasi që kjo duhet të bëhet sepse ju jeni udhëheqës për të gjithë qytetarët në këtë komunë, pra ne jemi këtu 3 veta nga 27 asambleista , ne jemi 15% në këtë mbledhje, ndërsa ju jeni të shurdhër në kërkesat dhe propozimet tona. Këtë sigurisht që nuk do ta durojmë dhe nuk do t'i japim legjitimitet

kësaj mbledhjeje. Në këtë mbledhje ne do të përcjellim kolegët tjerë të koalicionit, ku i thërrasim edhe ata të opozitës, të gjithë ata që mendojnë se kjo qeveri nuk është e mirë dhe që së bashku mos tu japim legjitimitet, deri sa nuk fillon që të zgjidhet problemi për bashkësinë serbe për të gjithë banorët e Istogut. Kaloni nëpër rrugë dhe shikoni se çfarë ndodhë, çdo ditë ka më pak njerëz, çdo herë e më shumë probleme, pra ju jeni përgjegjës për tërë këtë. I kam parashtruar pyetje direkt Kryetarit Rugova dhe pres përgjigje dhe njoftim, por jo sikurse herën e kaluar se kinse nuk e keni ditur, e pra tani e dini dhe do të veprojmë njësoj në të gjitha mbledhjet e ardhshme. Ju faleminderit shumë për vëmendjen dhe ju kërkoj ndjesë për kohën e marrë.

Kryesuesi, fjalën ia kaloj nënkryetarit.

Agim Ademaj, përshëndeti të pranishmit. Sa i përket asaj që e keni lëshu mbledhjen herën e kaluar është problem i juaji. A do të rrini apo jo në mbledhje është problem i juaji? A është punuar buxheti mirë apo jo, unë konsideroj që çdo përgjigje është shkelje e rendit të ditës ngase rendin e ditës e miratuam. Dhe do të punojmë në bazë të rendit të ditës që u miratua. Vullneti i juaj të qëndroni apo dilni është problem i juaji?

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje mungojnë: Haki Podrimaj dhe Jehona Haxhiqaj që besoj vijnë pa pak sepse nuk janë lajmëruar për mungesë dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë certifikuar. Gjithsej në mbledhje janë të pranishëm 22 (njëzetë e dy) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdoi me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, kuvendi me 20 vota për, 3 abstenime, miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Haki Podrimaj dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Kjo ka kaluar procedurat ligjore që parashihen. Në KPF është marr rekomandimi që kjo të kalojë në KK më një propozim, një taksë që të merret 5 euro për çdo therje në thertoret e licencuara. Mirëpo ka mbet të merret interpretimi nga Zyra Ligjore se a kemi të drejtë apo jo? Fjalën ia kaloi Hysni Maxharrit, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Hysni Maxharri, përshëndeti pranishmit. Rend ditë kemi Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba ku me këtë përcaktohen të gjitha të hyrat komunale, duke përfshirë taksat për kryerjen e shërbimeve, lejet, kërkesat dhe gjobat e ndryshme që do të arkëtohen nga drejtoritë komunale. Në fillim ju sqaroj së këto më ngjyrë të kuqe janë që të eliminohen ndërsa më ngjyre të verdhe të shtohen. Propozimi ka qene në KPF që çdo therje në thertore të merret takse 5 euro, ju kemi drejtuar Zyrës ligjore dhe kemi marr përgjigje. Duke u bazuar në Rregullore Nr.17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesave së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë, neni 11, kompetencat e marrjes së kësaj takse. Kjo pagese i bëhet Agjencisë së Ushqimit dhe veterinarisë.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Zenel Shatri dhe pastaj Arben Kabashi.

Zenel Shatri, përshëndet të pranishmit. Kam një pyetje lidhur me ndryshimet që janë bërë tani a përputhen më ligjet në fuqi. Ndërsa unë për këtë e kuptova se nuk paskemi drejtë për këtë takse 5 euro.

Arben Kabashi, falënderon për fjalën dhe përshëndeti të pranishmit. Kam disa vërejtje dhe i kam propozimet e mija për këtë rregullore. Tek neni 5 pika 5.2 referenca për operatorët ekonomik, propozojë të jetë 30 euro. Po e arsyetoj ky është një dokument që nuk lëshohet shpesh, ndërsa natyra e kjo pjesa janë shumë domethënëse për operatorët, çka e arsyeton që 100% kërkesën dhe pajisjen më këtë dokument. Po ashtu te pika 1.1 dhënia e certifikatës për vlerësimin e patundshmërive në komision, unë kisha kërkuar që këtu të zbritet prej 50 euro në 20 euro. Thjesht pse ka nevojë të ngarkohet qytetari kaq shumë me financa. Shembull për referencat e operatorit ekonomik janë vendos vetëm 5 euro në pikën 5.2 të rregullores. Po ashtu tjetër kam propozim që në pikën 1.1 participimi në bazë mujore për kopshtet e fëmijëve në Istog, Gurrakoc dhe Banjë, ku nga 25 euro e keni bërë në 30 euro. Pyes ku e gjënë njeri guximin me ndëshku kaq shumë prind në këtë rast? Se marre i vjen atij që e dërgon fëmijën në çerdhe ose ku janë kushtet që i ka ofruar vet komuna në ato çerdhe që me ngrit një tarifë prej 20 euro në 25 tani 30 euro. Kërkoi që të jetë në gjendjen e mëparshme 20 euro. Në Istog 25 qysh ka qenë në rregulloren e kaluar, jo mu ngrit për shkak se po rëndohet prindi në këtë rast. Tjetër kërkesë kam te pika 4.4 te shkollat e kembrixhit e keni paraparë një shumë 150 euro, unë kisha kërku që të jetë 400 euro. Tash llogariteni pse po kërkoj 400 euro, kur unë mund me lidh këtë në kuadër të asaj se tash llogariteni për nxënës, studentë e keni bërë ngritjen 4 euro, në një dokument të thjeshtë, ndërsa në shkollën e kembrixhit parashihni 150 euro pagesë. Te pika 9.1 është hajgare çfarë keni bërë në këtë rast, duhet të mbetet aq sa ka qenë. Nuk kam diçka të shtoj tjetër .

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Arif Elshani

Arif Elshani, përshëndeti të pranishmit. Unë kam një sqarim për regjistrimin e vonuar të vdekjeve me aktvendim, këtu po shënon 10 euro. Unë kam shqetësim nga qytetarët në këtë rast edhe unë. Për të çregjistrua një nënë lypet kurorëzimi i viteve 45, atë

certifikatë nuk mund ta gjej, jo vetëm unë. Dhe nuk po munden me çregjistru, kërkoi të dijë se pari tarifën dhe kushtet për të çregjistruar një të vdekur të jetë vërtetimi i mjekut. Unë për nënën time nuk mund të gjej këtë dokument dhe ende gjendet në listën e të gjallëve.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Agron Avdijaj.

Agon Avdijaj, përshëndeti të pranishmit. Unë pajtohem më atë që përmendi Arbeni dhe shqetësimin e Arifit. Unë dua të jap sugjerim, kjo rregullore të promovohet edhe më shumë të grupet e interesit sidomos aty ku ka ndryshime më të mëdha. Ne shpesh hasim në ankesa më qytetarët ngase nuk janë të informuar.

Kryesuesi, lidhur më këtë rregullorja ka qenë në diskutim publik. Do të jetë edhe në ueb faqe. Fjalën e ka kërku Radosh Repanoviq.

Radosh Repanoviq, të nderuar, tani mos të përsëris prapë, sepse i përmenden edhe kolegët tjerë para meje pothuajse të gjitha që desha t'i them, vetëm të ju them publikisht se ne

asamblastët nga Lista Serbe, nuk do të votojmë këtë pasi që e konsiderojmë katastrofal që i mbingarkon qytetarët, ju mundeni të siguron para në mënyra tjera, e jo të shtrenjtoni gjithçka që mundeni. Ne nuk do të votojmë për këtë. Nëse mendoi se nuk është kështu ju mund ta merrni fjalën. Ju thatë se jeni marrë vesh me zëvendës kryesuesin, ky nuk është problemi jonë, ky është problemi juaj.

Kryesuesi, jeni duke folur jashtë rendit të ditës, ke kaluar në pikë tjetër të rendit të ditës. Dikush tjetër a dëshiron fjalën, urdhëro Arben Kabashi?

Arben Kabashi, të pika 3.1 neni 5 pagesa për nxjerrjen e diplomës dublikat, ka qenë 1 euro tani është 5 euro. Këtu po rendohet nxënësi dhe studenti. Kjo është e papërbalueshme.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Eliot Kukiqi.

Eliot Kukiqi, sqarim të neni 5 pika 2.1, ngarkesa për punë jashtë orarit për biznese dhe hoteleri 30 euro. Si është e paraparë dhe çfarë orari?

Kryesuesi, i nderuar drejtor i keni disa pyetje.

Hysni Maxharri, te pyetja e Zenel Shatrit, përgjigjja është se përputhën të gjitha ndryshimet më ligjet në fuqi. Arben Kabashi, te neni 7 lidhur me çerdhet, çmimi ka qene 25 tani është 30 euro dhe të tjerat mbeten njëjtë. Te neni 5 dhënia e certifikatës për vlerësimin e patundshmërive është propozim të largohet ngase vlerësimin e bën Ministria e Financave. Te neni 10, lëshimi i pëlqimeve për kushtet teknike për qasje në infrastrukturën rrugëve pa shirita qarkullues përcjellës nga 30 euro të zbritet 10 euro.

Procesverbal

Referencat është paraqit e nevojshme dhe është parë e rrugës se duhet të propozohet. Te Arifi, regjistrimi i vonuar i të vdekurve të neni 2 pika 1.2, pas dy muajve largohet sepse kalon në gjoba. Ndërsa për një muaj është 50 euro nëse nuk e lajmëron në afatin e caktuar. Agron kjo rregullore vendoset në ueb faqe, njoftohet gjithë opinioni pasi që kjo kthehet nga shqyrtimi i ligjshmërisë. Te Eljoti, është fjala për zgjatjen e orarit të punës pas orës 24. Ai që dëshiron më zgjatë orarin e punës bënë kërkesë.

Agron Avdijaj, a ka kategorizim për pagesën jashtë orarit të punës?

Hysni Maxharri, neni 6 Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës 2.1, ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës për një ditë për të gjitha bizneset dhe hoteliere 30 euro. Janë tri kategori.

Kryesuesi, fjalën ja kaloj Arif Elshanit.

Arif Elshani, një sqarim të pika 1.2 është 10 euro. Mua po me intereson a hjeket kjo apo shkon te gjobat?

Hysni Maxharri, në fillim e kam thënë të gjitha ato që janë më ngjyrë të kuqe janë që të largohen apo hiqen. Kjo ka qenë takse por tani është gjobë në bazë të ligjit. Kjo largohet kur ju e aprovon.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Naim Imeraj.

Naim Imeraj, falënderoj për fjalën dhe përshëndeti të pranishmit. Mua po me intereson një ngritje të taksa për certifikatën e gjendjes martesore, prej 2 euro në 4 euro. Desha të dijë a keni ndonjë arsye të veçantë sepse është ngarkesë e madhe. A është e bazuar në diçka që ka kompetenca më të larta se sa ky kuvend apo është vlerësim i Drejtoratit të Administratës.

Hysni Maxharri, ky ka qenë propozim nga Drejtoria e Administratës.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Muhamet Ukajt.

Muhamet Ukaj, unë kisha propozua që rastet e vdekjes të regjistrohen me komision ose me dëshmitar, nëse nuk mund të gjejmë dokumentet brenda një kohë të caktuar të fshihen me dëshmitar. Unë kam pasur rast të tillë dhe ish dashtë të merret parasysh kjo. Ngase gjoba po rritet dhe nuk mundemi me fshi.

Hysni Maxharri, këtë e precizon ligji. E kemi pas taksën 10 euro por tani kalon në gjobë.

Kryesuesi, fjalën ja kaloi Zenel Shatrit pastaj Ajshe Metaj.

Zenel Shatri, përshëndeti të pranishmit dhe e përkrah mendimin e Naim Imeraj. Unë e përkrahi për arsye ngase statusi është dokumenti më së shumti që po ju duhet njerëzve dhe unë mendoj se duhet të mbes 2 euro.

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit. Pajtona me parafolësit e mijë dhe isha përqendruar të certifikata për kryerjen apo moskryerjen e shërbimit ushtarak. Kisha dashtë të dijë a është kjo pikë e re apo është vjelur edhe me herët kjo taksë?

Hysni Maxharri, kjo është të Drejtoria e Shërbimeve Publike, 9.2 do të thotë vërtetime të ndryshme, kemi parë që gjatë vitit kanë kërkuar këto lloje certifikatave. Kjo është bërë në kuadër të këtyre të ndryshme, tani është precize. Është inkasua edhe në vitet paraprahe.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Hajrush Shoshit dhe pastaj Arben Kabashi.

Hajrush Shoshi, përshëndeti të pranishmit, është bërë një pyetje për ngritjen e taksës për diploma. Sqarim deri tani ka qenë 1 euro por kanë qenë të obliguar me blerë diplomën dhe dëftesat. Kështu nga tani e tutje pajisen nga shkolla. Sa i përket ngritjes së taksës të çerdhet e fëmijëve kjo ka qenë. Por herën e kaluar ka ndodh një gabim teknik në Istog ka qenë 25 euro dhe kjo mbetet prapë 30 euro nuk ka ngritje.

Arben Kabashi, kam vërejtje te zonat urbane kemi 500 euro kompensim me qera vendosja e antenave. A është më mirë këtë tarifë me vendos 500 euro për shtëpi apo një zonë urbane që ju pengon të gjithëve?

Hysni Maxharri, vendosja e transmetuesve apo antena dhe kompensimi me qira, kjo është për zona urbane 500 dhe zona rurale 300.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Jehonë Haxhijajt.

Jehona Haxhijaj, përshëndeti të pranishmit. Kam pyetje pika 4.4 shkolla dhe kembrijet thatë që të largohet pagesa 150 euro arsyeja pse të largohet kjo pagese?

Hysni Maxharri, kërkoj falje që nuk jam përgjigjur. Arsyeja është se po privilegjohet një shkollë këtu dhe duhet të hiqet ngase qiraja është e precizuar me rregulloren përkatëse. Nuk bënë të precizohet asnjë shkollë.

Kryesuesi, deri tani kemi një propozim nga Naimi dhe e përkrahi Zeneli. Taksa nga 4 në 2 euro.

Mujë Osmanaj, përshëndeti të pranishmit. Mendoj se Zeneli e ka ngrit me vend një çështje dhe vërtet sipas ligjit ajo është ashtu dhe ne na u është përvjedhur një gabim dhe ajo pagesë të mbetet 1 euro. Janë shumë kategori që janë të lira.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Zenel Shatri.

Zenel Shatri, propozimin nuk e kam bërë unë por të mbetet që unë e bëra. Pasi e more fjalën edhe unë kam kërkesë për ju. Shërbimi i emergjencës në Qendrën mjekësore të Istogut mos të jetë vetëm një mjek dhe mos të jetë mjek i praksës së përgjithshme. Por të jetë një specialist patjetër sepse ju e dini sa problemet po dalin. Unë bëj apel te t'i si drejtor që në shtëpi të shëndetit të mos kujdestarojë vetëm një mjek dhe ai i praksës së përgjithshme. Para dy a tri netëve ka qenë një problem tjetër dhe unë kam qenë kujdestarë ka qenë mjek i praksës së përgjithshme ka filluar më hap dhe nuk po e zgjas se edhe ashtu jemi mjaft të përfolur nga gazetarët. Edhe çdo here të jenë dy ngase ju e dini njëri duhet të shkojë në teren dhe spitali mbetet vetëm dhe dalin probleme. Ndërsa çmimi propozoj të mbetet 1 euro jo 2 euro.

Kryesuesi, pyet kush është që propozimi i Zenel Shatrit për ekzaminimin mjekësor pa analiza dhe pa procedura plotësuese të jetë 1 euro?

Kuvendi vendosi me 18 vota për, 4 abstenime miratoi propozimin e Zenel Shatrit, që ekzaminimin mjekësor pa analiza dhe pa procedura plotësuese të jetë 1 euro. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Haki Podrimaj, Besa Ferati dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Kryesuesi, pyet kush është për që propozimi i Naim Imeraj për certifikatën e statusit martesor prej 4 te mbetet 2 euro?

Kuvendi vendosi me 19 vota për, 3 abstenime miratoi propozimin e Naim Imeraj, që Certifikata e Statusit martesor të mbetet 2 euro. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Haki Podrimaj, Besa Ferati dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Kryesuesi, unë mendoi së këtë e kemi shtjerr diskutimin, atëherë po votojmë kush është që kjo rregullore të miratohet me propozim të Naim Imeraj për statusin martesor taksa mbetet 2 euro dhe Zenel Shatrit për ekzaminimin mjekësor pa analiza dhe pa procedura plotësuese të jetë 1 euro? Pyes anëtarët e KK-së që kjo rregullore të aprovohet më këto dy propozim-ndryshime?

Kuvendi me 20 vota për, 3 abstenime miratoi Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba me propozim të Naim Imeraj dhe Zenel Shatrit. Obligohet shërbimi për punë të KK-së, të bëjë ndryshimet në rregullore më propozimet e dhëna. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Besa Ferati dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e plotësim-ndryshim rregullores për ndarjen e bursave për studentë. Rekomandimi i KPF-së është të përcillet në KK dhe të shpallet në diskutim publik. Fjalën ia kaloi Hajrush Shoshit, Drejtor për Arsim.

Hajrush Shoshi, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi plotësim-ndryshim rregulloren për ndarjen e bursave për studentë dhe komisionin që është caktuar nga kryetari për të punuar në këtë plotësim-ndryshim të rregullores për ndarjen e bursave për studentë.

Kryesuesi, atëherë pyes kush është që kjo të shpallet në diskutim publik?

Kuvendi më 20 vota për dhe 3 abstenime vendosi që të shpallet në diskutim publik plotësim-ndryshim rregulloren për ndarjen e bursave për studentë. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik Projekt-Rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal, miqësor për fëmijët. Fjalën ja kaloj Sanie Rugova, Udhëheqëse e Zyrës për barazi gjinore.

Sanie Rugova, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Projekt-Rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal, miqësor për fëmijët.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Naim Imerajt.

Naim Imeraj, nuk është hera e parë që kam pasur vërejtje për pjesën hyrëse të rregulloreve. Mos të mbeten vetëm në Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e komunës. Por mundësisht të ju referohet bazës ligjore e cila i mundëson formësimin nëse ajo ekziston si e tillë. Nëse ekziston një bazë ligjore një ligj që e përcakton një të drejtë eksplicite në raport në përbërjen e saj mirë kish me qenë të jetë në pjesën hyrëse të rregullores. E tregon një seriozitet dhe ne na ndihmon që të shikojmë edhe pak më gjatë se sa vetëm përmbajtjen. Faleminderit më dashamirësi më të madhe ishte vërejtja.

Kryesuesi, falënderoi Naim Imeraj dhe theksoi së beson kjo vërejtje do të merret parasysh nga ana e komisionit. Fjalën e ka kërkuar Ardita Idrizaj.

Ardita Idrizaj, përshëndeti të pranishmit dhe pyet si e shfrytëzojnë fëmijët këtë buxhet të fëmijëve?

Sanie Rugova, unë jam për të drejtat e njeriut dhe në kuadër të kësaj është edhe njësi për të drejtat e fëmijëve. Buxhet të ndarë nuk ka për fëmijët, në bazë të kërkesave shëndetësia ndanë buxhet për fëmijët e sëmurë. Po ashtu edhe drejtorati i arsimit i favorizon fëmijët për arsimim. Kështu që buxhet të ndarë nuk ka për fëmijët.

Kryesuesi, pyes anëtarët e Kuvendit kush është që kjo draft rregullore të shpallet në diskutim publik?

Kuvendi më 18 vota për dhe 3 abstenime vendosi që të shpallet në diskutim publik Projekt-Rregullorja për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal, miqësor për fëmijët.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani, Nexhmedin Balaj, Edona Lubeniqi dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së për vitin 2019. Bazuar në LVL, Statutin e komunës e kemi obligim përveç planit edhe kalendarin e takimeve në të cilin parashihen datat kur planifikohet të mbahen mbledhjet e KK-së dhe KPF-së. A dëshiron dikush fjalën nëse jo atëherë kush është për miratim të këtij kalendarit?

Kuvendi më 18 vota për 3 abstenime vendosi miratohet Kalendarin për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së për vitin 2019.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani, Lavdije Bujupaj, Edona Lubeniqi dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon me pikën e shtatë të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Fjalën ia kaloi Zenel Shatrit pastaj Arben Kabashi.

Zenel Shatri, kërkoi që në kohën e pyetjeve dhe përgjigjeve të jetë kryetari apo nënkryetari.

Arben Kabashi, pyetja e parë ka të bëjë me përgjegjësinë kryetarit, nënkryetarit dhe drejtorëve. Unë nuk di kujt t'i bëjë pyetje por se pari po ju drejtohem juve. Një pabarazi që po ndodh në Komunën e Istogut sidomos të punësimi. Unë si anëtar i asamblesë, një nga njerëzit kryesorë të PDK-së distancoja direkt nga koalicioni me LDK-në. Arsye është se që nga kur kemi bërë koalicion, që një vit kanë ndodhur 38 punësime të militantëve të LDK-së dhe kryesisht familjarë. I kam disa vendime dhe kam edhe

ankesa që ju kanë drejtuar edhe inspektoratit të punës në Pejë që kanë bërë shkelje. Është një jo transparencë nga ana e ekzekutivit ndaj atyre që aplikojnë për një vend punë. Po ashtu do t'i i marrë disa shembuj, Albert Ahmetaj i diplomuar në fakultetin e Edukatës Fizike në Universitetin e Prishtinës, çka ka ndodhë këtu, hapin konkurs nuk është hap një e u mbyll një por janë hap mbi 20 konkurse që unë i kam vendimet rend mundem edhe me ju dhanë. Paraprakisht përgatiten njerëz familjar për të hyrë në një vend pune, çoftë në arsim, çoftë në drejtorat për shërbime publike, që kjo ndodhi para tre a katër dite, thjeshtë me i punësu edhe ata njerëz që nuk e meritojnë, rrethin familjar me i eliminu ata njerëz të edukatës, njohurisë për çka aplikon. Jemi ardhur në një gjendje që nuk e di ju jeni në ngjarje, në vitin e kaluar është bërë një statistikë nga organizata joqeveritare në përgjithësi kështu, mbi gjashtë mijë vet vetëm katër vitet e fundit e kanë mor mërgatën për shkaqe të bllokadës nga ana e ekzekutivit për një vend pune, duke i rehatuar njerëzit familjar të vet tu i rahatu militant, se t'kishte me qenë klientel kisha thënë po kjo nuk është as klientel, po këtu është një çërkuz që ka than një këshilltar komunal. I kom katër vendime të mbylljes edhe pse i kanë plotësuar kriteret për me hy në punë ju keni bërë të padrejtë i keni mbyll konkursat me qëllim. Gjashtë mijë vet janë duke i pritur vizat me ec jashtë, gjithçka çka qeverisë në këtë vend në komunën e Istogut është e mbyllur. Unë nuk di çka te them me rendësi qytetarët se ju kanë besu votën e tyre, unë e thash mendimin tim si anëtarë ose si udhëheqës i grupit parlamentar të PDK-së distancona prej Lidhjes Demokratike në kuadër të koalicionit.

Kryesuesi, Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj, unë këtu e kam një kërkesë nga familja e Izet Shatrit këtë ja kisha drejtu kryetarit të komunës dhe besoj që kjo shkon edhe përmes zëvendës kryetarit. Kjo familje që nga viti i kaluar, ka bërë kërkesë që me vendos shtatoren e dëshmorit Izet Shatri, i cili ka rënë me 12 prill të 1999 në Lubozhdë. Kjo kërkesë është bërë edhe më herët por deri tash nuk ka pas diçka konkrete, kështu që unë përmes kësaj po i drejtona ekzekutivit. Është kërkesë e kësaj familje që me vendos shtatoren e dëshmorit, vendi është i caktuar edhe mundësisht me qenë e mundur me vendos shtatoren në ditën e çlirimit. Për këto besojë që edhe kryetari është i informuar për këtë material, besojë që është kërkesë e arsyeshme e meriton sepse gjaku i tyre faktikisht është liria jonë.

Kryesuesi, nënkryetari ka një sqarim.

Nënkryetari, sa i përket pyetjes së Ajshes për kërkesën e familjes së Izet Shatrit (dëshmorit), ne e kemi kërkesën e familjes po ju njoftojë juve dhe përmes juve të gjithë anëtarët e kuvendit, që është në shqyrtim e sipër dhe sigurt do të merret një vendim rreth kësaj kërkesë. Po më vjen keq prej Arbenit nuk e dëgjova prej fillimit fjalën e tij por këtë pjesën në fund, kështu çështja e konkurseve, çështja e pranimeve të kuadrit, keni parasysh janë ligjet, bazuar në ligje formohen komisionet kryejnë procedurat kush është i pa kënaqur ka të drejtë ankese. Shkalla e dytë mundet me ndodhë që e rrëzon konkursin nëse ka pas shkelje do të thotë është një procedurë ligjore, është e drejta e hapjes kontestit administrativ edhe në gjykata. Këto janë procedura që vazhdojnë për

secilin konkurs edhe janë të bazuara në ligj, Askush nuk është duke thënë se nuk ka mundësi me pas ndonjë situatë shkelje të konkursit, po ju them shumë sinqertë dy konkurse na kanë anulë më herët për shkak se e kemi lënë, kur është shpall konkursi është e domosdoshme njohja e gjuhës angleze që nuk ka qenë dhe nuk ish dashtë të jetë dhe për atë arsye është kthyer konkursi është e shënuar është në ligj edhe nuk ka asnjë problem përsëritet konkursi. Vazhdojnë procedurat nuk po shoh diçka, tash problemet brenda partisë kushtimisht po them të PDK-së në raste të caktuara të LDK-së apo të Aleancës, që ndodhin nuk duhet mu zbrazë këtu në asamble, dëgjo nuk është patericë e askujt askush, këto janë bërë kualiconet janë bërë me vullnet janë pajtuar me vullnet, vazhdojnë me vullnet prishen kur të na merr mendja njëres palë që nuk është në rregull njoftohen shkëputen gjithë kjo është normale.

Kryesuesi, fjalën e ka Agron Avdijaj pastaj Ajshe Metaj.

Agron Avdijaj, si duket ne ku jemi pajtuar që kjo pyetje të ndryshme të jetë si rend dite kemi bërë gabim sepse ish dashtë të jetë në fillim. Arsyeja e parë prezenca dhe mungesa e drejtorëve nga pjesa e fundit nuk janë prezent dhe e dyta madje edhe vet anëtarët e kuvendit po humb interesimi ndoshta edhe për shkak të lodhjes dhe kjo po mbet formalitet. Pasi këtu është drejtori kam pyetje për shqetësimet lidhur me menaxhmentin e Qendrës së mjekësisë familjare. Desha të dijë si është gjendja aktualisht? Shqetësimet janë bukur serioze.

Ajshe Metaj, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë për Arsim edhe me herët kemi ngrit çështjen që ka qenë rasti i pagave jubilarë dhe i tre i pagave të pensionit. Duke u bazuar në kontratën kolektive parashihet të behet pagesa e udhëtimit për të gjithë punëtorët që udhëtojnë mbi katër kilometra. Kjo të ne nuk ka ndodhur dhe pyes drejtorin.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Jehonë Haxhijajt.

Jehona Haxhijaj, më herët i thatë kolegut që po na malltreton me temën e punësimit realisht po më gëzon fakti që dikush e ngrit zërin për këtë sa i përket punësimit në komunën e Istogut. E dimë shumë mirë se janë mbajtur pezull vendet e punës dhe është nepotizmi familjar dhe politik që po na anashkalon dhe thjeshtë të mirët po mbesin në shtëpi për arsye se nënën amvise e babën bujk nuk kam si të qasem. Ju lutem mjaftë më këto gjera punësoni ata që meritojnë e jo në baza partiake.

Nënkryetari, sa i përket pyetjes Agronit po përgjigjem shkurt. Është në përgatitje e sipër konkursi pre drejtor dhe konkursi besoj do i mbyll pakënaqësitë. Sa i përket problemit të punësimit është telashe e madhe jo vetëm në komunën tonë po në gjithë Kosovën. Përderisa ekzistojnë procedura ligjore bazuar në cilat ai kandidat që e ndinë veten që ju ka shkel një e drejtë ka drejtë ankese, unë nuk po shohë diçka me bërë politike këtë çështje. Nëse vlerësohet se ka pasur shkelje anulohet konkursi.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Hajrush Shoshi, Ajshe Metaj dhe Arben Kabashi.

Hajrush Shoshi, kontrata kolektive e parasheh mirëpo mjetet nuk ka nga ministria që i ndanë për udhëtim. Kemi problem edhe për tri pagat e fundit se në çfarë forme duhet pagu ato mjete. Pa vendim të gjykatës nuk kemi drejtë me pagu, ministria e financave nuk e ka bere këtë.

Ajshe Metaj, drejtor po me vjen keq të pagat jubilarë janë paguar dhe për këtë arsye duhet planifikimi i buxhetit dhe kur planifikoni do t'i ndani. Edhe një e drejtë që është e garantuar nuk kemi pse mos me pasë të drejtë më kerku. Është e drejtë e jona dhe jam këmbëngulëse.

Arben Kabashi, komunat kanë marrëveshje me SBASHK-un për pagesën e pagave jubilarë. Përgjegjësia bien të komuna se nuk ka planifikuar mjete për këtë vit për t'i kompensuar. Nënkrjetar nuk desha të hyjë më emër dhe mbiemër. Janë 38 punësime dhe shumica prej tyre janë hapur dhe janë mbyll konkurset. Kjo ka ndodhur edhe para një jave nuk është zgjedhur ai me tri vite privat, të gjithë e dimë se është militant i LDK-së. Aty ka pasur njerëz më master që ka apliku dhe e keni anuluar pse?


Kryesuesi, fjalën ja kaloi Naim Imerajt.

Naim Imeraj, kisha inkuraju dhe bërë kërkesë te kolegët që nëse diçka tejkalon nivelin e pyetjes atëherë ne jemi të fuqishëm dhe të fort këtu dhe mundem të kërkojmë rend ditë. Andaj inkurajoj kolegun Arben që të propozojë pikën e rendit ditës dhe do të përkrahet nga grupi jonë. Nëse është teme e nuk janë të sotit e as të kohës por të këtij koalicionit jam në vazhdimësi, caktoni pikë të rendit ditës. Është çështje jetike dhe nuk ma ndalon askush me u mar me çështje. Inkurajoj që kushdo që dëshiron e ka përkrahjen tonë dhe debatimi në këtë mënyrë mund të jetë për nevoja të momentit dhe pak me të ngushta por duhet me zgjeru deri në interesin e qytetarëve të komunës për çka jam i gatshëm gjithmonë.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 12:00.

Procesmbajtëse,
Arlinda Kurtaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Qaush Balaj

